

# **RAPORT**

## **I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **PËR**

#### **VLERËSIMIN E JASHTËM TË PROGRAMIT TË STUDIMIT:**

*Master Profesional (MP) në Manaxhim,  
me profil “Manaxhimi i Pasurive të Palujtshme”*

**NË INSTITUCIONIN E ARSIMIT TË LARTË JO PUBLIK**

**“UNIVERSITETI MESDHETAR I SHQIPËRISË”**

**Eksperte: Prof.As. Dr. Manjola NACO**

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

### Hyrje

Komisioni i akreditimit vizitoi Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë gjatë muajit prill në datat 3 dhe 16 të vitit 2012. Komisionit të Vlerësimit ju krijuan të gjitha kushte për të përmbushur me sukses misionin e tij. Vizita u organizuar në mënyrë profesionale, dhe komisioni kishte një mundësi të mirë për t'u njohur me universitetin, stafin, studentët, punëdhënësit, bibliotekën, laboratorët, programin, si dhe me fasilitetet e tjera mësimore.

Komisioni fillimisht u takua me stafin drejtues të Universitetit, duke përfshirë ata që janë përgjegjës për programet për vlerësim. Misioni, objektivat dhe strategjitë e zhvillimit të Institucionit na u prezantuan nga Dekani, Prof.Dr. Kosta Barjaba kurse programi i ciklit të dytë i studimit master profesional me profil "Manaxhimin e Pasurive të Palujtshme", u prezantua nga Altin Hoti PhD.

Komisioni pati një diskutim të gjërë dhe konstruktiv me stafin akademik që do mbulojë realizimin e këtij program studimi. Ky intervistim aktiv qartësoj opinionin tonë në lidhje me këtë program studimi.

Vizita vijoi me vizitat në një numër ambjentesh mësimdhënie, laboratorësh të Institucionit, të udhëhequr nga stafi akademik. Një vizitë e shpejtë në Bibliotekën e Institucionit është realizuar gjatë inspektimit të kryer.

Në pasditen e dates 16, grupi vlerësimit intervistoj dhe mori opinionet e studentëve që ndiqnin këtë program studimi.

Komisioni pati akses të plotë në të gjitha materialet shtesë të programeve të studimit, si botimet e stafit mësimdhënës ashtu dhe punimet e studentëve.

Procesi i akreditimit ka qenë, sipas mendimit tonë, një përvojë pozitive dhe konstruktive për të Institucionin. Korrektesa e dokumentacionit të paraqitur në raportet e vetë-vlerësimit duhet të theksohet. Ky është raporti përfundimtar të vlerësimit të komisionit.

**Baza ligjore** e aktivitetit të **GVJ** për *vlerësimin e jashtëm të cilësisë* të UMSH<sub>se</sub> është:

- Ligji nr.9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", dhe akte të tjera nënligjore në mbështetje të tij. Sigurimi i jashtëm i cilësisë, sipas këtyre dispozitave realizohet nëpërmjet proceseve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë dhe Akreditimit, i cili kryhet nga Agjensia Publike e Arsimit të Lartë (APAAL).
- Vendimet e Këshillit të Ministrave për hapjen e programeve të studimit pranë UMSH.
- Udhëzimet e MASHit për projektimin e programeve të studimit, për hapjen dhe funksionimin e institucioneve private të arsimit të lartë, për transferimin dhe njohjen e krediteve, për administrimin e dokumentacionit, etj.
- Urdhëri nr.135 i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, datë 21.03.2011 "Për miratimin e standardeve shtetërore të cilësisë për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë të institucioneve të arsimit të lartë".
- Vendimi nr.482, datë 3.10.2011 i MASH "Për hapjen e programeve të ciklit të parë Bachelor, programeve të ciklit të dytë Master Profesional dhe Master i Shkencave në shkollën e lartë private Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë".

- Udhëzues i APAAL mbi vlerësimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë.
- Aspektet dhe treguesit e vlerësimit të cilësisë në Arsimin e Lartë (APAAL).

### **Metodologjia për hartimin e raportit**

Për hartimin e këtij raporti, GVJ është mbështetur në:

- Shqyrtimin dhe analizimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, të hartuar nga grupi i vlerësimit të brendshëm të UMSHsë.
- Shqyrtimin dhe analizimin e dokumentacionit bazë mbi të cilën organizohet e gjithë veprimtaria e zhvillimit të programeve mesimore, të tilla si rregulloret dhe udhëzimet, dosjet e programeve të studimit, regjistrat themeltarë, dokumentacioni i zyrës së burimeve njerëzore, kurrikulave, karrierës dhe financës, si dhe sekretarisë mësimore.
- Vëzhgimet e kryera gjatë vizitës në vend tek UMSH si dhe në intervistimet e stafit drejtues të universitetit, pedagogëve, studentëve dhe stafit administrativ.

### **Parimet e Punës së GVJ kanë qenë:**

Besimi se, duke shqyrtuar me kujdes dokumentacionin e paraqitur nga aplikuesi dhe duke ballafaquar njohuritë e marra nëpërmjet tyre me realitetin në institucion, do të të ndihmojë në akreditimin e këtij masteri dhe të jap edhe sugjerime për përmirësimin e mëtejshëm të programit.

Vlerësimi të mbështetet kryesisht në dokumentat e paraqitura nga GVB dhe Institucioni ndërmjet të cilëve mund të përmendim: raportin e vetvlerësimit të brendshëm, programet (curriculat) e lëndëve e moduleve, etj.

### **Grupi i vlerësimit përbëhet nga**

#### **Eksperti i jashtëm**

Prof.As. Dr. Manjola NACO

### **Të dhëna për Programin e Studimit në Master Profesional në Manaxhim me profil “Manaxhimin e Pasurive të Palujtshme”**

Ky program është hapur në vitin akademik 2011-2012

<b>Tabela format</b> për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit Master Profesional në Manaxhim me profil “Manaxhimi i Pasurive të Palujtshme, mbështetur në Standardet shtetërorë për programet e studimit të Ciklit të Dytë	
<b>Standardet/kriteret</b>	<b>Mendimi i GVJ për përmbushjen e standardit/kriterit<sup>1</sup></b>

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

<b>I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE</b>	
<b>Standardi I. 1</b> <b>- Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Gjatë procesit të vlerësimit, referuar edhe Raportit të Vlerësimit të Brendshëm, komisioni arriti në konkluzionin e qëndrueshëm se programi i studimit është i organizuar në përputhje me këtë kriter. Aktualisht asnjë student nuk e ka kryer këtë nivel studimi. Gjatë këtij procesi, arritën në një bindje pozitive në lidhje me krijimin e mundësive për të ofruar specialist në drejtimin e portofoleve të pasurive të patundshme, si një kërkesë e tregut, por bazuar në dokumentacionin e sekretarisë vëmë re se nuk ka tërheqjen e mjaftueshme të studentëve.
<b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri e kënaqshme</b> Komisioni gjeti përputhshmëri në raport me këtë kriter. Programet e vëna në dispozicion nga Institucioni dhe dokumentacioni mbështetës.
<b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri e kënaqshme</b> Komisioni gjeti përputhshmëri në raport me këtë kriter. Raporti i vlerësimit të Brendshëm është marrë si bazë për të gjykuar në lidhje me qëllimet dhe misionin e Institucionit.
<b>Kriteri 4</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Konstatohet se specializimi në drejtim të manaxhimit të pasurive të palujtshme vjen në një moment, kur interesi në lidhje me portofolin e pasurive të palujtshme është në një nivel të lartë, ndërkohë që nuk ka shumë programe të ngjashme që mund të plotësojnë këtë boshllëk, lidhur me krijimin e specialistëve që merren me administrimin dhe manaxhimin e pasurive të palujtshme. Studime të ndryshme që vlerësojnë nevojat e tregut për këtë lloj specialiteti, kanë qënë në vëmendje të komisionit kur vlerësoj këtë lloj programi ( <i>PROMISES – Municipal PROperty Management In South-Eastern Cities</i> )
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni nuk evidentoi papërputhshmëri në raport me këtë kriter.
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b> Komisioni nuk evidentoi papërputhshmëri në raport me këtë kriter.

<p><b>Konkluzione:</b>  Programi i “Manaxhimit të Pasurive të Palujtshme”, është një program që plotëson një kërkesë të tregut të punës për specialistë që do fokusohen në krijimin e portofoleve të mire manaxhuara të pasurive të palujtshme si për institucionet publike edhe ato jopublike. E rëndësishme është që institucioni të mendojë për formulën më të përshtatshme për promovimin e këtij program në mënyrë që të tërhiqen, ata të cilët mund të përfitojnë maksimumin nga një program i tillë. Gjykojmë se një program i tillë fillimisht duhet tu drejtohet specialistëve që mbulojnë administrimin e pasurive të patundshme të institucioneve lokale dhe qëndrore për të rritur kapacitetet e tyre në këtë proces.</p>	
<p><b>Standardi I.2</b>  - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b>  Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri e kënaqshme</b>  Komisioni gjeti përputhshmëri të plotë në raport me këtë kriter. Vlerësimi është bazuar në raportin e Vlerësimit të Brëndshëm.</p>
<p><b>Kriteri 2</b>  Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfillt të profesional;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Programi i studimit “Manaxhim i pasurive të palujtshme”, si një program studimi profesional, synon pajisjen e studentëve që do ta frekuentojnë atë me njohuri të thelluara duke filluar nga mënyrat e evidentimit deri në metodat e vlerësimit dhe më pas manaxhimit më profesional të pasurive të palujtshme. Gjykim i bazuar në analizën e moduleve që përmban ky program studimi.</p>
<p><b>Kriteri 3</b>  Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Ky program është i konceptuar si vazhdim i logjikës së studimeve të kryera në administrim biznesi në nivelin Bachelor, duke synuar një nivel specializimi por dhe zgjerimin e njohurive të fituara në ciklin e parë të studimit. Gjykim i bazuar në analizën e moduleve që përmban ky program studimi</p>
<p><b>Kriteri 4</b>  Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p>	
<p><b>Kriteri 5</b>  Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Komisioni nuk evidentoi papërputhshmëri në raport me këtë kriter. Gjykim i bazuar në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm.</p>

<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>	
<p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qarta profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Programi i studimit “Manaxhimi i pasurive të palujtshme” nënvizon objektiva të qarta për të përgatitur specialistë me kualifikimin e nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e një tregu pune në rritje.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Ky program studimi është në përshtatje të plotë me strategjinë e institucionit për zhvillim, ai është i konceptuar si vazhdim llogjik i studimeve të kryera në administrim biznesi në nivelin Bachelor, por gjykojmë se në rastin e programit të manaxhimit të pasurive të palujtshme konceptimi i programit është në funksion të atyre që merren me administrimin e pasurive të palujtshme të cilët jo domosdoshmërisht duhet të kenë studiuar për administrim biznesi</p>	
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Komisioni nuk evidentoi papërputhshmëri në raport me këtë kriter. Baza legislative dhe Programi i vënë në dispozicion.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Komisioni nuk evidentoi papërputhshmëri në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Në hartimin dhe implementimin e këtij program, është mbajtur parasysh plotësimi i kushteve dhe parakushteve të rrjedhura nga Ligji i Arsimit të Lartë dhe Udhëzimeve përkatëse të MASH. Përmbajtja e këtij program studimi është në përputhje me kriteret e përcaktuara në Udhëzimet përkatëse të MASH</p>	
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Komisioni nuk evidentoi papërputhshmëri në raport me këtë kriter. Raporti i vlerësimit të Brëndshëm shërbeu si referencë në vlerësimin e këtij kriteri.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Vlerësimi i studentëve në lidhje me ecurinë e tyre por dhe nivelit të asimilimit të dijeve në kuadër të këtij program bëhet</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Me anë të provimit me shkrim që përbën 60% të vlerësimit përfundimtar</li> <li>2. Detyra dhe prezantime në lidhje me aspekte aplikative të moduleve që përbën</li> </ol>

	40% të vlerësimit përfundimtar
<p><b>Konkluzione:</b> Përmbajtja dhe objektivat e moduleve të këtij programi studimi janë në funksion të arritjes së objektivit kryesor, ofrimin e specialistëve me dije të thelluara për drejtimin e pasurive të patundshme. Vlerësimi dhe kontrolli i dijeve të fituara në modulet e këtij programi bëhet nëpërmjet kombinimit të provimeve me shkrim dhe temave dhe detyrave të ndryshme të cilat mbrohen me gojë. Një kombinim i tillë gjykohet si formalisht i përshtatshëm në vlerësimin sa më të plotë të studentëve për dijet e fituara gjatë cdo moduli. Vëmë re se ndiqet e njëjta strukturë vlerësimi për të gjitha modulet e programit duke nënvizuar një nivel uniformiteti, jo në funksion të specifikave të cdo moduli dhe objektivit që ai përfaqëson në strukturën e programit të ofruar. Gjykimi i komisionit u bazua në analizën e moduleve përkatëse të programit të studimit por edhe Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm.</p>	
<p><b>Standardi I.5</b> - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikën e mira të vendeve europiane</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Programi i ofruar merr në mënyrë të konsiderueshme në konsideratë modelet e ngjashme të ofrura në vende si France, Gjermani dhe në mënyrë specifike vjen në një linjë me kuadrin EMUNI. Gjykimi i bazuar në informacionin e ofruar nga Raporti i Vlerësimit të Brëndshëm</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Programi i ofruar është shumë ambicioz në drejtim të elementëve në përbërje të tij duke synuar të arrijë një dimension ndërkombëtar me synimin kryesor për të afirmuar vlerat më të mira të arsimit universitar në Shqipëri. Gjykimi bazuar në analizën e programeve të ngjashme në universitete të njohura në botë.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Programi i ofruar është në frymën e përgjithshmë të rregullimeve të BE si për arsimin e lartë dhe për profesionet e rregulluara</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Ky program studimi është hartuar duke u bazuar në një numër të konsiderueshëm modelesh të ngjashme në vende si France, Gjermani etj. E gjykojmë si një program të hartuar mbi ambicien për të arritur një dimension ndërkombëtar dhe në afirmim të vlerave të mira të arsimit tonë universitar. Gjykimi i bazuar në analizën e programeve të ngjashme në universiteteve të njohura si dhe në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm.</p>	
<p><b>Standardi I.6</b> - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Ky program synon pajisjen e studentëve me njohuri të qëndrueshme dhe tenton aftësimin profesional në një specialitet të ngushtë sic është manaxhimi i pasurive të palujtshme.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri e kënaqshme</b>  Ky program studimi hartohet në përputhje të plotë me profilin e UMSH dhe strategjinë për zhvillim që ka ky institucion</p>

<p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizmin e programeve të studimeve;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri e mjaftueshme</b></p> <p>Programet e ofruara janë frut i punës kërkimore shkencore e personelit akademik në mbështetje të këtij program studimi. Gjykimi I bazuar në materialet që na u vunë në dispozicion nga Institucioni gjatë vizitës në të.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b></p> <p>Komisioni nuk eidentoj papërputhshmëri në raport me këtë kriter. Gjykimi I bazuar në materialet që na u vunë në dispozicion nga Institucioni gjatë vizitës në të</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Ky program vjen si hapësirë e re për aftësimin profesional të studentëve në manaxhimin e pasurive të palujtshme, si pjesë e rëndësishme e biznesit por edhe e entiteteve publike. Ai vjen në përputhje të plotë me profilin e UMSH dhe strategjinë për zhvillim që ka ky institucion. Hartimi i këtyre programeve të studimit ka në themel punën kërkimore dhe shkencore të personelit akademik të brëndshëm dhe të jashtëm të angazhuar në këtë proces, punime të skeduar në bibliotekën e Universitetit</p>	
<p><b>Standardi I.7</b> <b>- Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b></p> <p>Aftësimi I thelluar në drejtime të caktuara të manaxhimit dhe vecanërisht atë të pasurive të palujtshme është duke u konsoliduar si nevojë e tregut të pasurive të palujtshme, treg që jo vetëm ka njohur rritje por po tenton dhe vendosjen e rregullave të qarta të lojës në të. (shpjeguar ne kriterin 4 te Standardit I.I)</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b></p> <p>Programi i “Manaxhimit te pasurive te Palujtshme” gjykohet si një risi, që do të përgatiste specialist të mirëfilltë për këtë sektor me shumë problematika në Shqipëri.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Programi i masterit profesional në “Manaxhimin e pasurive të palujtshme” ofrohet në kohën e duhur dhe me drejtimin e duhur, duke synuar të përgatisë specialistë të mirëfilltë për një sektor me shumë problematika në Shqipëri, atë të tregut të pasurive të palujtshme, treg që ka njohur rritje të vazhdueshme.</p>	
<p><b>Standardi I.8</b> <b>- Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri relative</b></p> <p>Komisioni eidentoj përputhshmëri relative në raport me këtë kriter, si pasjë e faktorëve objektivë jashtë institucionit. Gjykimi I bazuar ne analizen strategjike sektoriale dhe Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm.</p>



<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;</li> <li>kërkesat e punëdhënësve;</li> <li>një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;</li> <li>numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra.</li> </ol>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri relative</b></p> <p>Komisioni nuk pati në dispozicion një vlerësim të tregut të punës për këtë lloj specialiteti, të kryer nga Institucioni. Nuk ka studime të mirëfillta apo vlerësime të nevojave të tregut për specialist të manaxhimit të portofoleve të pasurive të palujtshme.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Ky program studimi gjykojmë se ka një përputhshmëri relative me kriteret e këtij standardi. Ky pozicioni i grupit të vlerësimit vjen si pasojë e analizës deductive bërë në këtë rast. Gjykojmë se ky program studimi është ofruar si rrjedhojë e një intuitede praktike dhe një njohje të plotë të aspekteve strategjike të zhvillimit ekonomik të vendit si i tillë nuk është bazuar në një vlerësim të numrit të studentëve të pritshëm në këtë program si pasojë e mungesës së një studimi të nevojave të tregut për këtë lloj specialiteti. Duke qënë një program avangardë nuk gjetëm ngashmëri me programet e ofruara nga institucionet simotra të arsimit të lartë.</p>	
<p><b>Standardi I.9</b> <b>- Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b></p> <p>Komisioni nuk evidentoj papërputhshmëri në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b></p> <p>Komisioni nuk evidentoj papërputhshmëri në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Gjykojmë se në këtë program studimit nuk evidentuam papërputhshmëri me interes kombëtar dhe kërkesave për ruajtjen e vlerave kulturore dhe kombëtare.</p>	
<p><b>Standardi I.10</b> <b>- Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b></p> <p>Nisur nga konteksti rregullativ, institucioni e bazon vlerësimin e programeve në krahasimin me ecurinë e programeve të ngjashme të studimit në vendet ku u bazua për të hartuar këtë program por e gërshetuar kjo me një konsultim të gjërë me trupën akademike dhe ekspertët më të mirë të fushës. Gjykim bazohet edhe në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p>	

<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri relative</b></p> <p>Ka nje politike transparence (e theksuar edhe ne Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm) në lidhje me rezultatet e vlerësimit por për shkak të jetëgjatësisë së shkurtër të institucionit, nuk na u krijuan kushtet për të gjykuar në lidhje me zbatimin e kësaj politike.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta: <u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>Pyetje konceptuale;</li> <li>Intervista;</li> <li>Etj.</li> </ol> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>Dëgjime në auditor;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</li> <li>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> <li>Etj.</li> </ol>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri relative</b></p> <p>Nisur nga konteksti rregullativ, institucioni e bazon vlerësimin e programeve si në sondazhe ashtu dhe intervista, pyetje konceptuale, dëgjimi në auditore, rezultate të studentëve në provime dhe realizimin e detyrave të kursit etj. Për shkak të historikut të shkurtër nuk na u krijua mundësia të gjykonim realizimin e plotë të këtij procesi të rëndësishëm. Na u vunë në dispozicion anketa të vlerësimit të mësimdhënies nga studentët, rezultate të provimeve të ndërmjetme dhe detyra kursi për disa nga lëndët që zhvillohen në këto programe studimi, por të pamjaftueshme për gjykim të plotë për plotësimin e këtij kriteri.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni ka metodologji vlerësimi për ecurinë e programeve të studimeve. Institucioni ka një kornizë rregullative (del qartë edhe në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm) ku tregohen metodologjitë që përdoren për të gjykuar ecurinë e programeve por dhe instrumentet e vlerësimit. Për shkak të historikut të shkurtër të Institucionit nuk mund të gjykonim në mënyrë të plotë në lidhje me realizimin e këtij procesi kompleks.</p>	
<p><b>Standardi I.11</b> - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri relative</b> Sipas kornizës rregullative të institucionit, bazuar në ecurinë e programeve të ngjashme në vende të ndryshme hartohet një plan strategjik për përditësimin e programeve, theksuar në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri relative</b> Sipas kornizës rregullative të institucionit, për programet institucioni harton plan strategjik edhe në drejtim të përmirësimit të mësimdhënies dhe rezultateve të të nxënit sic theksohet në Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Bazuar në kornizën rregullative të institucionit, procesi i vlerësimit ndiqet nga procesi I planifikimit strategjik si në drejtim të përmirësimit (përditësimit) të programeve por edhe në lidhje me metodat e mësimdhënies dhe rezultatet e të nxënit. Nuk ka nivele të synuara (të përcaktuara) në drejtim të rezultateve të të nxënit dhe metodave të mësimdhënies. Theksojmë se duke qënë se historiku është I shkurtër nuk kish mundësi të testonim një process të tillë.</p>	
<p><b>Standardi I.12</b> - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.</p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;</p>	
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri e kënaqshme</b> Ky program studimi realizohet me 60 kredite, dhe kohëzgjatja është 1 vit akademik me kohë të plotë.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).</p>	
<p><b>Konkluzione:</b> Ky program studimi “Master Profesional” realizohet me 60 kredite. Ka një kohëzgjatje 1 vit akademik në sistemin me kohë të plotë. Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Ligji i Arsimin të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar</p>	
<p><b>Standardi I.13</b> - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	

<b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri relative</b>
<b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri relative</b>
<b>Konkluzione:</b> Duke qënë se historiku i shkurtër i Institucionit, nuk na krijon mundësinë për të vlerësuar plotësimin e këtij standardi, gjykimin tonë e bazojmë në parimin e besimit duke marrë për bazë dokumentacionin që na u vu në dispozicion nga Institucioni në momentin e inspektimit.	
<b>II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I INSTITUCIONIT BËHET NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE.</b>	
<b>Standardi II.1</b> <b>- Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Komisioni nuk evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter. Dokumentacioni I vënë në dispozicion pranë institucionit na ndihmoj në këtë gjykim
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Komisioni nuk evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter. Dokumentacioni I vënë në dispozicion pranë institucionit na ndihmoj në këtë gjykim
<b>Konkluzione:</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve. Në kontratat e angazhimit ka specifikime të detyrave të secilit në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të ofruara.	
<b>Standardi II.2</b> <b>- Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b>  Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni ka së paku dy Fakultete;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b>  Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.
<b>Kriteri 3</b> Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b>  Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.
<b>Kriteri 4</b> Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b>  Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.

<p><b>Kriteri 5</b> Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij. Institucioni ka dy Fakultete. Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka tri njësi, nga të cilat dy departamente. Fakulteti përbëhet nga, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar. Nga dokumentacioni që na u vu në dispozicion në momentin e vlerësimit, rezulton përputhshmëri relative në lidhje me kriterin 5. Raporti I Vlerësimit të Brëndshëm është në të njëjtën linjë më këtë gjykim.</p>	
<p><b>Standardi II.3</b> <b>- Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve si dhe I njohin mirë përgjegjësitë e tyre në lidhje me rekrutimin e personelit akademik të nevojshëm për realizimin e programeve. Bazuar ne kornizën rregullatore të brëndshme të institucionit këto njësi bëjnë dhe vlerësimin e këtij personeli akademik, ky fakt theksohet edhe në raportin e Vlerësimit të Brëndshëm.</p>	
<p><b>Standardi I</b> <b>I.4</b> <b>- Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Hartimi I kurrikulës është përgjegjësi direkte e stafeve akademike të brëndshme dhe të jashtme</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Nga dokumentacioni i vene ne dispozicion ne momentin e vlerësimit, komisioni nuk arriti të identifikojë ndonjë papërputhshmëri në raport me këtë kriter. Dokumentacioni i vënë në dispozicion na krijoj mundësinë për të gjykuar në lidhje më këtë kriter.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Personeli akademik angazhohet në hartimin e kurrikulës dhe vendimet në lidhje me organizimin e programeve të studimit. Rekrutimi dhe përcaktimi I ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Ligji i Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” I ndryshuar, Udhëzimet e MASH dhe kuadri rregullator i Institucionit (statute dhe rregulloret e brëndshme), vlerësim I cili është bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion në momentin e vlerësimit</p>	
<p><b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b> Institucioni zhvillon aktivitetin e saj në një godinë të marrë me qera në të cilën zhvillohet veprimtaria mësimore dhe ndodhet edhe mjedisi qendror administrativ</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Mjediset janë marrë në qera për një periudhë 10 vjecare</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b> Mësimdhënia dhe aktivitete e tjera zhvillohen në një godinë duke siguruar në këtë mënyrë një kontroll të vazhdueshëm dhe menaxhim efikas</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë duke vënë në dispozicion një godinë bashkëkohore dhe që i përgjigjet standardeve të ofrimit të një shërbimi cilësor dhe shumë afër standardeve europiane dhe në gjërë. Godina është funksionale dhe ofron kapacitetet e kërkuara. Ajo është marrë me qera për një periudhë 10 vjecare.</p>	
<p><b>Standardi II.6</b> <b>- Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b> Broshurat dhe fletëpalosjet sjellin modulet afër studentëve duke i bërë të konsultueshme në çdo moment</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Programet e studimit i ofrohen studentëve si në formë të shkruar dhe elektronikisht</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni u siguron studentëve mjaftueshëmrisht informacion për tu konsultuar, në lidhje me programet e studimeve si në formë të shkruar dhe elektronike. Gjykim bazuar në informacionin e mbledhur nga studentët brënda Institucionit por edhe materialet që na u vunë në dispozicion.</p>	
<p><b>Standardi II.7</b> <b>- Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri relative</b> Korniza rregullatore e institucionit, parashikon analizën vjetore për vlerësimin dhe ecurinë e programeve. Historiku i shkurtër i këtij institucioni nuk na dha mundësi të vlerësonim plotësimin e këtij kriteri në momentin e inspektimit.</p>

<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri relative</b></p> <p>Korniza rregullatore e institucionit, parashikon hartimin e politikave të tilla</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Korniza rregullatore e institucionit (theksuar edhe ne Raportin e Vlerësimit të Brëndshëm) parashikon analizën vjetore për vlerësimin dhe ecurinë e programeve si dhe hartimin e politikave që synojnë përmirësimin e tyre, por komisioni nuk pati mundësi të vlerësonte vënin në zbatim të këtyre planeve për shkak se ky program ishte akoma në vitin e parë të ofrimit të tij.</p>	
<p><b>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b></p> <p>Programi i studimit “Manaxhimi i Pasurive të Palujtshme” shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	
<p><b>Konkluzione:</b> Ky program studimi shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve.</p>	
<p><b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b></p> <p>Bazuar në informacionin e vënë në dispozicion, në momentin e vlerësimit, rezulton se institucioni ishte në mes të një procesi auditimi të pasqyrave financiare. Audituesi i jashtëm është shoqëria AIEI Auditors. Institucioni na vuri në dispozicion kontratën me këtë shoqëri.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b></p> <p>Për sa kohë që institucioni kalon procesin e auditimit ligjor të pasqyrave financiare në gjerësi se raporti do të përmbajë grantet e përfituara apo kontratat e shërbimit për realizimin e programeve, kërkesë e specifikuar në kontratën e auditimit.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b></p> <p>Komisioni është i prirur të besojë se ky informacion do të jetë pjesë e Raportit të auditimit</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni i nënshtrohet procesit të auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare çdo vit. Ky proces auditimi nënkupton plotësimin e kriterëve të këtij standardi. Kontrata e auditimit specifikon kërkesa të tilla.</p>	
<p><b>III - PERSONELI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PËRBËHET NGA PERSONELI AKADEMIK,</b></p>	

<b>PERSONELI NDIHMËS MËSIMORSHKENCOR DHE PERSONELI ADMINISTRATIV.</b>	
<b>Standardi III.1</b> <b>- Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Kudri rregullativ përmban rregulla ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit. Rregulloret e Institucionit japin procedurat për procesin e rekrutimit.
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;	
<b>Kriteri 3</b> Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Kudri rregullativ përmban procedura transparente të vlerësimit të personelit
<b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Institucioni ka një bazë të dhënash për procesin e rekrutimit të personelit
<b>Konkluzione:</b> Institucioni ka një set të plotë rregullash dhe procedurash mjaftueshmërisht transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit. Për pjesën e procedurave të kryera ka një bazë të plotë të dhënash për këtë proces.	
<b>Standardi III.2</b> <b>- Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.
<b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.
<b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.



<p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Konkludojmë se institucioni plotëson kriteret e këtij standardi. Duhet të theksojmë se ndryshimet që ishin bërë në lidhje me zëvendësimin e titullarit të dy moduleve (për shkak të humbjes së jetës) nuk ishin pasqyruar në Planin Mësimor. Personeli akademik që na u komunikua gjatë intervistimeve të stafit akademik që angazhohej në këtë program, plotëson kriteret e kërkuara për një titullar moduli. Theksojmë se me fluksin aktual të studentëve, gjykojmë se institucioni nuk ka vështirësi në plotësimin e kërkesave për udhëheqje apo mbikëqyrje praktikash.</p>	
<p><b>Standardi III.3</b> - <b>Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p>	
<p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	
<p><b>Konkluzione:</b> Ka një program të qartë të hartuar në lidhje me angazhimin e personelit akademik në veprimtari shkencore në kuadër të këtij program studimi, duke të krijuar bindjen që institucioni po ecën me hapa të shpejtë në drejtim të plotësimin të këtij standardi, megjithëse nuk mund të evidentonim më shumë në lidhje me këtë ecuri në momentin e vlerësimit</p>	
<p><b>Standardi III.4</b> - <b>Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p>	<p>Nuk është i aplikueshëm</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Nuk është i aplikueshëm</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni nuk ofron programe mësimdhënieje në gjuhë të huaj, megjithëse ka marrveshje bashkëpunim për realizimin e leksioneve të hapura me profesorë të huaj ekspertë të fushave të ndryshme</p>	
<p><b>Standardi III.5</b></p>	

<b>- Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;	
<b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;	
<b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.	
<b>Konkluzione:</b> Në momentin e vlerësimit nuk patëm mundësi të kishim një informacion të tillë pasi programi ishte në një moment të hershëm, pra nuk kishin bërë akoma ndarjen e udhëheqjeve të temave për këta student.	
<b>Standardi III.6</b> <b>- Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.	
<b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.	
<b>Konkluzione:</b> Në momentin e vlerësimit nuk patëm mundësi të kishim një informacion të tillë pasi programi ishte në një moment të hershëm, pra nuk kishin bërë akoma ndarjen e udhëheqjeve të temave për këta student.	
<b>Standardi III.7</b> <b>- Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me ketë kriter.
<b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me ketë kriter.
<b>Konkluzione:</b>	

<p>Ndihet një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e objektivave të këtij program studimi. Intervistimet e stafit na krijuan mundësinë për një gjykim të tillë.</p>	
<p><b>Standardi III.8</b> - <b>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Bazuar në dokumentacionin (e arkivuar në institucion) e vënë në dispozicion në momentin e vlerësimit, komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion në momentin e vlerësimit, komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore. Kjo ngarkesë vlerësohet me orë mësimore.</p>	
<p><b>Standardi III.9</b> - <b>Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Komisioni evidentoj përputhshmëri të mjaftueshme në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Komisioni evidentoj përputhshmëri të mjaftueshme në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b>  Komisioni evidentoj përputhshmëri të mjaftueshme në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni ka një zyrë të burimeve njerëzore në të cilën gjenden një bankë e plotë të dhënash për personelin akademik të brëndshëm dhe të jashtëm dha të personelit ndihmës mësimor-shkencor si dhe të gjitha rregulloret që institucioni ka parasysh në rastin e rekrutimit të këtij personeli.</p>	
<p><b>Standardi III.10</b> - <b>Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p>	
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni ka politika të qarta angazhimi në kualifikimin e vazhdueshëm të personelit të tij akademik, të cilat duhet të gjykojnë në kohë për zbatimin e tyre dhe efektet që mund të sjellin në drejtim të përmirësimit të programeve të studimit dhe jo vetëm. Komisioni nuk mund të shprehet në lidhje me</p>	

përputhshmërinë e plotë të këtij program, për shkak të historikut të shkurtër të institucionit.	
<b>Standardi III.11</b> - <b>Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore -shkencore të personelit akademik të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	
<b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	
<b>Kriteri 3</b> Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	
<b>Konkluzione:</b> Institucioni kish një bibliotekë me tekste, monografi, libra, artikuj dhe revista me shkrime dhe punime që vijnë në ndihmë të realizimit të programit të ofruar. Institucioni dhe më saktë cdo njësi e tij ka një bazë të dhënash për veprimtarinë kërkimore dhe shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi por jo drejtpërdrejtë në ndihmë të këtij program.	
<b>IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE</b>	
<b>Standardi IV.1</b> - <b>Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Studentët që ndjekin këtë program masteri profesional kanë së paku diplomën Bachelor (180 kredite)
<b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Gjatë inspektimit të dosjeve të studentëve të pranuar në këtë program (4 studentë) arritëm në konkluzion se institucioni ka zbatuar kushtet e ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, për pranimet në programet e integruara të studimit.
<b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Studentët e këtij program plotësojnë kriteret e pranimit të institucionit
<b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Studentët janë të informuar se deri në fund të këtij programi studimi duhet të japi gjuhën angleze të nivelit B2

<p>integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Historiku i shkurtër i programit, nuk na dha mundësinë të gjujkojmë në lidhje me këtë program</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni plotëson mjaftueshmërisht kriteret e këtij standardi, studentët pranohen në përputhje me kërkesa e ligjit për arsimin e lartë dhe në përputhje me kushtet e pranimit të vetë institucionit, gjithashtu ata janë të informuar në lidhje me përmbushjen e detyrimit të mbrojtjes së gjuhës angleze (niveli B2) përpara përmbylljes së këtij program studimi.</p>	
<p><b>Standardi IV. 2</b> - <b>Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri të mjaftueshme në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të mjaftueshme</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri të mjaftueshme në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit. Studentët kanë informacion mbi nivelin e akreditimit të institucionit dhe programit të studimit si dhe diplomës së lëshuar nga institucioni. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës</p>	
<p><b>Standardi IV. 3</b> - <b>Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri në diskutim</b> Institucioni tani nxjerr brezin e parë të të diplomuarve.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Institucioni disponon rregjistra mbi numrin e studentëve të regjistruar në këtë program studimi të ciklit të dytë, nuk ka të dhëna për largime para përfundimit të këtij program</p>

<p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni është në momentin e diplomimit të brezit të parë të studentëve të sitemit Bachelor. Në sekretarinë e institucionit ka një bankë të dhënash statistikore mbi numrin e studentëve të rregjistruar ne programet e ciklit të dytë të studimeve si dhe ecurinë akademike të studentëve të këtij program deri në diplomimin e tyre. Gjykojmë për një përputhshmëri të mjaftueshme në lidhje me këtë standard.</p>	
<p><b>Standardi IV. 4</b> - <b>Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p>	<p>Nuk është i aplikueshëm</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Nuk është i aplikueshëm</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni është në momentin e diplomimit të brezit të parë dhe nuk mund të ketë të dhëna për statistika punësimi pas diplomimit</p>	
<p><b>Standardi IV. 5</b> - <b>Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Studentët kanë të gjithë informacionin që l duhet në lidhje me programet e studimit</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimi gjatë dhe në përfundim të progrmait</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Titullari i modulit diskuton hapur me studentin për rezultatet</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni ndjek politikë të informimit të vazhdueshëm të studentëve dhe të detajuar jo vetëm për programet dhe afatet e përfundimit të moduleve por dhe të vlerësimit të tyre gjatë dhe në përfundim të programit. Informacion l mbledhur nga dokumentacioni por dhe diskutimet me studentwt e programit.</p>	
<p><b>Standardi IV. 6</b> - <b>Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me këtë kriter.</p>

<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me ketë kriter.</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni angazhon struktura të specializuar që janë në mbështetje dhe në ndihmë të studentëve për zgjidhjen e problematikave të procesit mësimor por dhe si këshilluese për ecurinë e mëtejshmetë tyre. Nw institucion ndodhej zyra e karrieres.</p>	
<p><b>V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI</b></p>	
<p><b>Standardi V. 1</b> <b>- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me ketë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me ketë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me ketë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri në raport me ketë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b> Institucioni ka një planifikim të mirë të aktiviteteve mbështetëse në shërbim të procesit mësimor</p>
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni ka një bibliotekë të pasur e cila e vënë në shërbim të studentëve ndikon në realizimin e përmbushjes me sukses të qëllimit dhe misionit të vetë institucionit për plotësimin me dije bashkëkohore të të gjithë atyre që e duan arsimimin.</p>	
<p><b>Standardi V. 2</b> <b>- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b> Komisioni evidentoj përputhshmëri të plotë në raport me ketë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 2</b></p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b></p>

Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;	Komisioni eidentoj përputhshmëri të plotë në raport me këtë kriter.
<b>Kriteri 3</b> Labororët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b>  Komisioni eidentoj përputhshmëri të plotë në raport me këtë kriter.
<b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b>  Komisioni eidentoj përputhshmëri të plotë në raport me këtë kriter.
<b>Konkluzione:</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore të cilët ndihmojnë në realizimin e misionit për realizimin e studimeve sa më cilësore dhe të konkurueshme në të gjitha drejtimet.	
<b>Standardi V. 3</b> <b>- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri të kënaqshme</b>  Komisioni eidentoj përputhshmëri të plotë në raport me këtë kriter.
<b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	
<b>Konkluzione:</b> Institucioni ka marrvëshje afatgjat bashkëpunimi me institucione të rëndësishme si dhoma e tregtisë dhe industrisë duke patur akses bashkëpunimi me shumë biznese në fusha të ndryshme duke patur mundësi të relaizojë praktika të sukseshme për realizimin e këtij programi	
<b>VI - INSTITUCIONI KA DHE MENAXHON BURIMET FINANCIARE</b>	
<b>Standardi VI.1</b> <b>- Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operationale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Nisur nga parimi I besimit, gjykojmë se institucioni ka analiza të thelluara të kostove të cdo aktiviteti në funksion të përmbushjes së detyrimit të ofrimit të studimeve të ciklit të dytë.
<b>Kriteri 2</b>	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>



Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	Nisur nga parimi I besimit, gjykojmë se institucioni ka kapacitet financiarë për të ardhmen.
<b>Konkluzione:</b> Institucioni ka një përdorim të kënaqshëm të informacionit për qëllime të vendimarrjes por përderisa informacioni I kosto-drejtimit është vetëm për drejtimin dhe nuk mund të vihet në dispozicion të të huajve nuk patë aksesin e nevojshëm për vlerësim. Vlerësimi jonë u bazua në parimin e besimit dhe në dokumentacionin e VGB të institucionit.	
<b>VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI, TË BRENDSHME DHE TË JASHTME</b>	
<b>Standardi VII.1</b> <b>- Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;	
<b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.	
<b>Konkluzione:</b>	
<b>Standardi VII.2</b> <b>- Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;	<b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b>  Institucioni ka marrveshje bashkëpunimi me institucione homologe të vendit dhe të huaja
<b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;	
<b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;	
<b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	
<b>Konkluzione:</b> Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit të rëndësishme për rritjen e kapaciteteve të brëndshme të tij dhe jo vetëm	
<b>VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË</b>	
<b>Standardi VIII.1</b> <b>- Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p>	<p><b>Vlerësimi: Përputhshmëri</b></p> <p>Komisioni evidentoj përputhshmëri të plotë në raport me këtë kriter.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>	
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p>	
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p>	
<p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p>	
<p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	
<p><b>Konkluzione:</b> Institucioni është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve. Perceptimi i komisionit gjatë procesit të vlerësimit ishte se Institucioni ka një ndjeshmëri të lartë në drejtim të sigurimit të cilësisë të programeve dhe jo vetëm, por për shkak të historikut të shkurtër të këtij institucioni, të gjitha strategjitë, instrumentat për sigurimin e cilësisë janë programe të hedhura bukur në letër. Nuk mund të jepnim një gjykim të plotë në lidhje me këtë standard.</p>	

### **Analiza për Programin e Studimit Master Profesional në Manaxhim me profilin “Manaxhim i Pasurive të Palujtshme”**

#### **Pikat e forta**

1. Infrastruktura bashkëkohore dhe kushtet mjaft të mira për zhvillimin e procesit mësimor
2. Numri i marrveshjeve të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare homologe dhe në nivel kombëtar është mbresëlënës
3. Stafi është entuziast dhe relativisht i ri
4. Studentët janë shumë të kënaqur nga komunikimi dhe ndërveprimi me pedagogët.
5. Disponueshmëria e pedagogëve për konsultim dhe mbikëqyrje është e lartë
6. Programi është nën monitorim dhe përmirësim të vazhdueshëm

#### **Pikat e dobëta**

1. Numri shumë i vogël i studentëve
2. Mungesa e një studimi për këtë treg pune (vlerësimi i kërkesës)
3. Mungesa e kërkimeve shkencore vendase në lidhje me modulet specifike të këtij program
4. Mungesa e profesorëve të specializuar kryesisht në modulet specifike të këtij program studimi

## Rekomandime

Në analizën e bërë më lart, ndër pikat e forta të UMSH rreshtuam: Infrastrukturën moderne duke përfshirë godinën, klasat, laboratorët, sallat optimale të leksioneve dhe seminareve, kushtet optimale me ngrohje e ftohje, mundësia e përdorimit të teknologjisë së informacionit; Bashkëpunimet me institucione brenda vendit dhe universitete të huaja; Numri i marrveshjeve të bashkëpunimit me institucione ndërkombëtare homologe dhe në nivel kombëtar është mbresëlënës, entuziazmi i stafit relativisht të ri, i cili te komunikonte motivimin dhe përkushtimin në realizimin e misionit që kishin marrë përsipër. Por në mënyrë që këto pika të forta të mos sfumohen, lidhur me këtë program studimit subjekt i akreditimit: Programi i studimit të ciklit të dytë MP në Manaxhim me profil “Manaxhimi i Pasurive të Palujtshme” jepen sugjerimet e mëposhtme:

1. Duhet që institucioni të mendojë për një fushate të drejtë promovimi për këtë lloj program midis palëve të interesuara.
2. Duhet që institucioni të fokusohet në ngritjen e kapaciteteve të personave që merren kryesisht me manaxhimin e pasurive të palujtshme.
3. Kontrolli i cilësisë duke përdorur reagime edhe nga studentët duhet të kryhet në mënyrë sistematike për të gjitha programet e studimit.
4. Institucioni duhet të thellojë punën për të tërhequr personel shumë të kualifikuar në fushat specifike të programit të studimit të Manaxhimit të Pasurive të Palujtshme.
5. Informacion për të gjitha planeve, eventet, materialet për të gjitha modulet, dhe rezultatet individuale studimore duhet të bëhen sa më shpejt në mënyrë elektronike për tu vënë në dispozicion për të gjithë studentët.

Si përfundim, pasi kam shqyrtuar, analizuar dhe vlerësuar: cilësinë e programeve të studimit të ciklit të dytë MP në Manaxhim me profilin “Manaxhimi i Pasurive të Palujtshme” hartimin, zbatimin e standardeve të cilësisë dhe përpjekjet e vazhdueshme për cilësi të qëndrueshme, gjendjen aktuale të institucionit të arsimit të lartë jo publik “Universiteti Mesdhetar të Shqipërisë” të kombinuar me infrastrukturën dhe teknologjinë bashkëkohore që ky institucion ofron; **i rekomandoj APAAL<sub>it</sub> dhe KA<sub>së</sub> që institucionit të arsimit të lartë jo publik: “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH)”, t’i jepet akreditimi për programet e studimit ciklit të dytë MP në Manaxhim me profil “Manaxhimi i Pasurive të Palujtshme”**

## Ekspertë i Jashtëm:

Prof.As. Dr. Manjola NACO